



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2022:021732

Datë: 18.12.2023

Numri i dokumentit: 05080924

PPP. nr. 6/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË GLLOGOC Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Astrit Gashi, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit L.G nga Gllogoci, kundër debitorit B.K nga Komuna e Gllogocit, lidhur me borxhin në shumën prej 890 €, duke vendosur në prapësimin e ushtruar nga debitori, kundër urdhërit për lejimin e përmbartimit të Përmbartuesit F.B, P.nr... i datës 17.01.2022, jashtë seance me datë 18.12.2023 e mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET prapësimi i debitorit B.K nga Komuna e Gllogocit, kundër urdhrit të Përmbartuesit Privat P.nr... i dt.17.01.2022, me të cilin është lejuar propozimi i kreditorit L.G nga Gllogoci, për përmbartimin e borxhit në shumën prej 890 € me kamatë ligjore prej 8 % në vit nga dita e vënjes në vonesë e gjer në pagesën definitive, ndërsa Urdhëri i Përmbartuesit Privat P. Nr... i datës 17.01.2022 **mbetet në fuqi**.

A r s y e t i m

Kreditori L.G ka parashtruar propozimi te Përmbartuesi Privat F.B nga Gllogoci për lejimin e përmbartimit në bazë të Dokumentit Noterial me shenjen LRP nr. Rend... e datës 06.09.2019, lidhur me pagesën e borxhit kryesore në lartësi prej 890 €, me kamatë vjetore prej 8 %, si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat 7 ditor në të kundërtën, të bllokohen llogaritë bankare të debitorit, e nëse nuk ka mjete në llogari të bëhet regjistrimi, sekuestrimi, vlerësimi dhe shitja e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme e mjetet e mbledhura të derdhen në llogari të kreditorit.

Përmbartuesi Privat F.B, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit, ka lëshuar Urdhër me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të Dokumentit Noterial me shenjen LRP nr. Rendor... të datës 06.09.2019 së bashku me shpenzimet e procedurës përmbartimore, në të cilin dokument debitori ka deklaruar se: *ia ja borxh kreditorit shumën prej 890 Euro që do të ia paguaj kreditorit gjer me datën 20.09.2019 në të kundërtën deklaron se ky dokument do të përdoret në*

procedurën përbarimore si titull ekzekutiv dhe jap pëlqimin për përbarim të dhunshëm në pasurinë time të luajtshme dhe të paluajtshme për kryerjen e detyrimeve ndaj kreditorit.

Debitori ka paraqitur prapësim kundër Urdhërit për lejimin e përbarimit në afatin ligjor me arsyetimin se dokumenti në bazë të cilit është nxjerr urdhëri përbarimor nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përbarueshmërisë, si dhe ka skaduar afati kohor brenda të cilit sipas ligjit mund të kërkohet përbarimi i dhunshëm, andaj ka kërkuar që në vështrim të Nenit 5 par. 5 të LPP-së të aprovohet si i bazuar prapësimi i tij dhe të refuzohet si i pa bazuar urdhëri për përbarim i përbaruesit privat.

Kreditori në afatin ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësim duke kundërshtuar prapësimin e debitorit në tërësi si të pa bazuar dhe të pa argumentuar me asnjë provë, andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzoj prapësimin e debitorit dhe Urdhëri P. nr... të datës 17.01.2022 të mbetet në fuqi.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se prapësimi i debitorit është pa i bazuar, ndërsa kundërshtimet e prapësimit të dhëna nga kreditori në përgjigje në prapësim, gjykata i konsideroi si të qëndrueshme dhe atë për këto arsye.

Me shikimin e shkresave të lëndës vërtetoi faktin se kreditori, propozimin për përbarim e ka bërë për përbarimin e dokumentit të përbarueshëm–Dokumentit Noterial me shenjën LRP nr. Rendor... e datës 06.09.2019 të lartëcekur për shkak të detyrimit në të holla si më lartë, i cili propozim është lejuar me Urdhërin e Përbaruesit Privat e me propozimin e mjeteve gjegjëse të përbarimit të parapara me dispozitat ligjore të LPP-së për realizimin e detyrimit në të holla që rrjedh nga këto ekstrakte si në rastin konkret.

Lidhur me atë se me çfarë baze juridike caktohet përbarimi, se çka përmban dokumenti i përbarimit, se çka duhet të përmbajë një propozim për përbarim të dokumentit të besueshëm, si dhe kushtet ligjore për caktimin e përbarimit në bazë të ekstrakteve janë të përcaktuara me dispozitat ligjore të Nenit 21, 29, 37, 38 dhe 40 të LPP-së, ndërsa shkaqet e prapësimit janë përcaktuar në Nenin 71 të LPP-së, e në rastin konkret kemi të bëjmë me dokumentin noterial të përbarueshëm nga i cili dokument shihet se debitori i ka borxhin në fjalë kreditorit.

Debitori në prapësimin e tij ka pretenduar se nuk ka obligim ndaj Kreditorit pasi që nuk ka bazë ligjore për të kërkuar përbarim sipas dokumentit noterial se i njëjti nuk është dokument noterial përkatësisht klauzola e përbarueshmërisë nuk është vendosur në formën e duhur, gjykata nuk e aprovoj këtë pretendim të debitorit pasi që dokumenti noterial është i përbarueshëm në pajtim me Ligjin për Noterinë dhe Nenin 22 dhe 26 të LPP-së, ndërsa kreditori në anën tjetër propozimit për përbarim i ka bashkangjitur aktin noterial të vërtetuar të cilat i plotësojnë kushtet ligjore për tu trajtuar dokument i përbarueshëm në kuptim të Nenit 29 par. 1.2 të LPP-së.

Lidhur me pretendimin se është parashkruar kërkesa e kreditorit pasi që procedura nuk është filluar brenda 3 viteve, gjykata në kuptim të dy dispozitave ligjore të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së) si më poshtë vlerësoj se një pretendim i tillë i debitorit nuk është i bazuar. Neni 347 par. 1 i LMD-së përcakton se “Njohja me shkrim e detyrimit të parashkruar konsiderohet si heqje dorë nga parashkrimi”. Neni 352 i LMD-së (Afati i përgjithshëm i parashkrimit) përcakton se “Kërkesat parashkruhen për pesë (5) vjet, në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit”. Debitori e ka pranuar se ia ka borxh debitorit shumën prej 890 Euro me datën 06.09.2019 përmes dokumentit noterial të lartëcekur ndërsa

propozimi për përmbarim është paraqitur me datën 17.01.2022 përkatësisht pas 2 vjet e 4 muaj e 11 ditë.

Andaj, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke e refuzuar prapësimin e debitorit dhe ka lënë në fuqi urdhërin përmbarues për caktimin e përmbarimit P.nr... të datës 28.02.2020 duke u bazuar në Nenin 73 par. 3 të LPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Dega në Gllogoc
Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.6/22, datë 18.12.2023

Gj y q t a r i
Astrit Gashi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi nuk e ndalon procedurën përmbarimore përveç nëse janë dhënë garancitë për shumën e plotë të kredisë sipas Nenit 78 të LPP-së.